



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 170

Tiranë – E mërkurë, 14 shtator 2016

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 606, datë 31.8.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.....	20363
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 7.9.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar””, të ndryshuar.....	20365
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 7.9.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Shëtitorja Qeparo loti 2” dhe “Shëtitorja Qeparo loti 1”, Himarë.....	20366
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 7.9.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i galerisë për kabllot e rrjetit shpërndarës të nënstacionit qendër 110/20 kv”, Tiranë.....	20368
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 630, datë 7.9.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës Unaza “1 Maji”, Himarë”.....	20369
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 631, datë 7.9.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe kthimi në identitet i godinës së Prefekturës së Qarkut Tiranë”.....	20370
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 7.9.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Pedonalja “Abaz Bej Lushnja””.....	20372

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 633, datë 7.9.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 661, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, Skelë - Uji i Ftohtë, Bashkia Vlorë".....	20373
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 7.9.2016	Për lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë së veprës së artit në pikturë "Krijim i kooperativës në Malësi", e autorit Zef Shoshi, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, e cila do të marrë pjesë në ekspozitën "Shqipëria, 1207 km në Lindje", që organizohet në Muzeun e Qytetërimeve të Evropës dhe Mesdheut (MUCEM), në Marsejë, Francë.....	20374
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 638, datë 7.9.2016	Për miratimin e rregullores për trajtimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë.....	20375
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 640, datë 7.9.2016	Për kalimin e sporteleve të shërbimit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).....	20397
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 642, datë 8.9.2016	Për lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 36 negativëve prej xhami, pjesë e fondit të Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi", Shkodër, në Muzeun e Fotografisë së Amsterdemit - FOAM, Holandë, në kuadër të zhvillimit të ekspozitës fotografike "Dinastia Marubi - <i>Marubi Dynasty</i> " - 100 vite të Studios Fotografike Shqiptare, në Amsterdam.....	20398



LISTA

Nr.	Imazhi	Nr. i inv.	Titulli	Autori	Teknika	Përmasa	Viti	Çmimi, lekë
1.		1604	Krijimi i kooperativës në malësi	Zef Shoshi	Vaj	184 x 220.5 cm	1974	200,000

VENDIM

Nr. 638, datë 7.9.2016

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
TRAJTIMIN E SIGURT TË MBETJEVE
RADIOAKTIVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 100, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore për trajtimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 8, datë 7.1.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullore “Për trajtimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë””, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe të gjitha institucionet që përmenden në përmbajtjen e rregullore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE
PËR TRAJTIMIN E SIGURT TË MBETJEVE
RADIOAKTIVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË

Neni 1**Objekti i rregullore**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullores dhe i kërkesave për trajtimin e sigurt të

mbetjeve radioaktive dhe përcaktimi i kërkesave të veçanta për licencimin e qendrave për trajtimin e mbetjeve radioaktive.

Neni 2**Përcaktime**

Në kuptim të kësaj rregulloreje, me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

a) “Karakterizim”, përcaktimi i vetive fizike, kimike dhe radiologjike të mbetjes radioaktive për të krijuar mundësinë për përshtatje të mëtejshme, trajtim, kondicionim, përpunim të mëtejshëm, ruajtje të përkohshme ose vendosje në depon përfundimtare.

b) “Niveli i çlirimit”, një vlerë e vendosur nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe e shprehur në termat e përqendrimit të aktivitetit. Në ose nën këtë vlerë, burimi i rrezatimit sipas një praktike mund të hiqet nga kontrolli rregullator.

c) “Kondicionim”, çdo proces i cili prodhon një paketim të përshtatshëm për mbetjen radioaktive për transport, ruajtje të përkohshme ose vendosje në depon përfundimtare. Ky proces mund të përfshijë kthimin e mbetjes në formë të ngurtë, mbylljen e mbetjes në kontejner dhe, nëse është e nevojshme, parashikimin e një paketimi ekstra.

d) “Kontejner”, ena në të cilën është vendosur mbetja radioaktive gjatë përpunimit, transportit, ruajtjes së përkohshme ose vendosjes në depo përfundimtare; ena është, gjithashtu, element i paketimit të mbetjes radioaktive, që përfaqëson barrierën e jashtme mbrojtëse të mbetjes radioaktive nga ndërhyrjet e jashtme.

e) “Shkarkim”, një shkarkim i planifikuar dhe i kontrolluar i materialeve radioaktive të lëngëta ose në formë hiri (gaze ose aerosole) në mjedis me origjinë nga instalimet gjatë një pune normale, brenda limiteve të autorizuara nga Komisioni për



Mbrojtjen nga Rrezatimi. Ky proces kryhet sipas një praktike të ligjshme.

dh) “Depo përfundimtare”, çdo instalim, qëllimi kryesor i të cilit është vendosja përfundimtare e mbetjeve radioaktive.

e) “Burime të mbyllura që nuk përdoren më”, një burim i mbyllur i cili ka pak kohë që nuk përdoret ose nuk ka qëllim të përdoret më për praktikën për të cilin është dhënë një autorizim, por që vazhdon të kërkojë menaxhim të sigurt.

ë) “Sistemi i menaxhimit të mbetjeve radioaktive”, një set elementesh të ndërlidhura ose bashkëvepruese për të krijuar politika dhe objektiva dhe mundësimin për arritjen e përmbylljes së objektivave në mënyrë efektive.

f) “Paketim”, procesi i përgatitjes së mbetjeve radioaktive për transport, ruajtje ose vendosjen në depon përfundimtare nëpërmjet mbylljes së saj në një kontejner të përshtatshëm.

g) “Rishikimi periodik i sigurisë”, rivlerësimi sistematik i sigurisë së depon së menaxhimit të mbetjeve radioaktive ekzistuese, i cili kryhet në intervale të rregullta. Ky rivlerësim merret me efektet kumulative të vjetërsisë, modifikimet, eksperiencën e funksionimit, zhvillimet teknike dhe aspekte të ndërtimit dhe ka për qëllim të garantojë nivele të larta të sigurisë gjatë gjithë kohës së shërbimit të depon ose gjatë aktivitetit të saj.

gj) “Përpunim i ndërmjetëm”, çdo veprim që kryhet përpara vendosjes përfundimtare ku përfshihen aktivitetet, si: paratrajtimi, trajtimi, kondicionimi, ruajtja dhe transporti.

h) “Përpunimi”, çdo proces që ndryshon karakteristikat e mbetjeve radioaktive ku përfshihen paratrajtimi, trajtimi dhe kondicionimi.

i) “Sigurimi i cilësisë”, të gjitha veprimet e planifikuara dhe sistematike, sistemet, komponentët ose procedurat për të siguruar cilësi të përshtatshme, të zhvilluara në përputhje me standardet e miratuara; kontrolli i cilësisë është pjesë e sigurimit të cilësisë.

j) “Mbetje radioaktive”, çdo material radioaktiv i ngurtë, i lëngët ose i gaztë, i cili nuk do të përdoret më për qëllime të mëtejshme, i miratuar si i tillë nga subjekti ose trupa rregullatore.

k) “Menaxhimi i mbetjeve radioaktive”, të gjitha proceset që lidhen me përpunimin, paratrajtimin, kondicionimin, ruajtjen dhe vendosjen përfundimtare të mbetjeve radioaktive, duke çliruar transportin e tyre.

l) “Depo e menaxhimit të mbetjeve radioaktive”, çdo objekt ose instalim, qëllimi kryesor i të cilit është trajtimi i mbetjeve radioaktive.

ll) “Vlerësimi i sigurisë”, vlerësimi i të gjitha aspekteve që lidhen me mbrojtjen nga rrezatimet dhe sigurinë për një objekt të autorizuar. Kjo përfshin vendndodhjen, ndërtimin dhe funksionimin e objektit.

m) “Masat e sigurisë”, çdo veprim që ndërmerret, kusht që aplikohet ose procedurë që ndiqet për të plotësuar kërkesat e kësaj rregulloreje.

n) “Sigurimi”, masat për të parandaluar ndërhyrje ose transferta të paautorizuara, dëmtime, humbje ose vjedhje të mbetjeve radioaktive.

nj) “Dosja e sigurisë”, një grup/paketë argumentesh dhe evidencash në mbështetje të sigurisë së depon, duke përfshirë rezultatet e vlerësimit të sigurisë dhe një deklaratë besimi të këtyre rezultateve.

o) “Ndarja”, një aktivitet ku të gjithë tipat e mbetjeve radioaktive ndahen ose mbahen të ndarë bazuar në vetitë e tyre kimike, fizike dhe radiologjike për të lehtësuar trajtimin ose përpunimin e mbetjeve radioaktive.

p) “Trajtimi”, procesi dhe mënyra/metoda e ndryshimit të karakteristikave të mbetjeve radioaktive nëpërmjet zvogëlimit të vëllimit, largimit të radionuklideve nga mbetja radioaktive ose ndryshimi i strukturës/përbërjes me qëllim përfitimin ekonomik dhe rritje të sigurisë së saj.

q) “Pako e mbetjeve radioaktive”, përgatitje e mbetjeve radioaktive për transport, ruajtje të përkohshme dhe ruajtje të përhershme, nëpërmjet mbylljes së formës së mbetjeve së kondicionuar në një kontejner të përshtatshëm.

r) “Forma e mbetjeve radioaktive”, forma fizike dhe kimike e mbetjeve radioaktive që pas përpunimit dhe kondicionimit rezultojnë si një masë e ngurtë e gatshme me paketim.

PJESA I

KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Neni 3

Përgjegjësitë

Strukturat përgjegjëse për sigurinë dhe sigurimin e mbetjeve radioaktive janë, si më poshtë:

a) Përdoruesi i licencuar për aktivitete që gjenerojnë mbetje radioaktive;



b) Personi i licencuar për depon e menaxhimit të mbetjeve radioaktive dhe kjo përgjegjësi nuk delegohet;

c) KMR-ja përcakton politikat kombëtare për menaxhimin e mbetjeve radioaktive, në bashkëpunim me autoritetet e tjera kompetente në Shqipëri;

ç) KMR-ja krijon një program kombëtar për zbatimin e politikave për menaxhimin e mbetjeve radioaktive.

Neni 4

Programi Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve Radioaktive

1. Programi Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve Radioaktive mbulon të gjitha llojet e mbetjeve radioaktive që gjenden në Shqipëri dhe të gjithë hapat e menaxhimit të mbetjeve radioaktive nga prodhimi deri në depon përfundimtare.

2. Programi Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve Radioaktive përfshin informacionin e mëposhtëm:

a) Objektivat e përgjithshëm të politikës kombëtare të Shqipërisë për menaxhimin e mbetjeve radioaktive;

b) Pikat e rëndësishme dhe afatet kohore për arritjen e tyre;

c) Inventarin e të gjitha mbetjeve radioaktive dhe llogaritjet për sasinë e mbetjeve që do të krijohen në të ardhmen, duke përfshirë mbetjet që vijnë nga mbyllja e aktiviteteve dhe duke përcaktuar qartë vendin e sasinë e mbetjeve radioaktive, në përputhje me klasifikimin e mbetjeve radioaktive;

ç) Planet, konceptet dhe zgjidhjet teknike për mbetjet radioaktive nga prodhimi deri në vendosjen në depon përfundimtare;

d) Planet, konceptet për periudhën pas përfundimit të jetëgjatësisë së një depoje përfundimtare, duke përfshirë periudhën në të cilën janë bërë kontrollet e duhura dhe janë ruajtur të dhënat për depon për një kohë të gjatë;

dh) Praktikat më të mira, krijimin dhe demonstrimin e aktiviteteve që duhen me qëllim zbatimin e zgjidhjeve për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive;

e) Përgjegjësinë për zbatimin e programit kombëtar dhe indikatorët e performancës për të monitoruar progresin e implementimit;

ë) Një vlerësim të kostove të programit kombëtar duke vënë në dukje bazën dhe hipotezën për këtë vlerësim, i cili duhet të përfshijë:

i) skemën financiare në fuqi;

ii) një politikë transparente financiare.

3. Programi kombëtar dhe hapat për menaxhimin e mbetjeve radioaktive rishikohen dhe përditësohen rregullisht, duke marrë parasysh progresin teknik e shkencor, sipas rekomandimeve dhe praktikave të mira ndërkombëtare e rajonale.

Neni 5

Programet operative të menaxhimit të mbetjeve radioaktive

1. Personat e licencuar për aktivitete që gjenerojnë mbetje radioaktive, të krijojnë dhe të zbatojnë programe operative për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive, në përputhje me Programin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve Radioaktive.

2. Programet operative të menaxhimit të mbetjeve radioaktive përfshijnë:

a) të gjithë tipat e mbetjeve radioaktive që prodhohen nga aktivitetet;

b) të gjithë hapat e menaxhimit të mbetjeve radioaktive nga prodhimi deri në vendosjen në depon përfundimtare, duke marrë parasysh ndërvlerësitë ndërmjet tyre dhe impaktin e parashikuar në vendosjen në depon përfundimtare.

3. Programet operative të menaxhimit të mbetjeve radioaktive të rishikohen dhe të përditësohen në mënyrë periodike, duke marrë parasysh progresin teknik dhe shkencor.

4. Programi operativ i menaxhimit të mbetjeve radioaktive përfshin informacionin e mëposhtëm:

a) Inventarin e sasisë ekzistuese të burimeve radioaktive dhe parashikimin e sasive që mund të shtohen në të ardhmen, përfshirë ato që vijnë nga mbyllja për të cilat duhet të kemi një informacion të qartë për vendin dhe sasinë e materialit, klasifikimin dhe nivelin e rrezikut;

b) Konceptet, planet dhe zgjidhjet teknike për menaxhimin e mbetjeve radioaktive, nga prodhimi deri në vendosjen në depon përfundimtare;

c) Elementet kryesore, afatet kohore të qarta dhe përgjegjësitë për zbatimin e programit;

ç) Treguesit kryesorë të performancës që monitorojnë progresin e zbatimit të programit;



d) Një vlerësim të kostove për trajtimin e mbetjeve.

5. Programet operative të menaxhimit të mbetjeve radioaktive aprovohen nga KMR-ja gjatë procesit të licencimit të aktivitetit ose subjektit që prodhon mbetje radioaktive.

Neni 6

Sistemet e menaxhimit të mbetjeve radioaktive

1. Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive, si dhe të licencuarit e depos së menaxhimit të mbetjes radioaktive sigurojnë që sistemi i menaxhimit të parashikojë sigurimin e cilësisë, i cili aplikohet në të gjitha fazat e menaxhimit të mbetjes radioaktive.

2. Ky proces të aplikohet në të gjitha aktivitetet që lidhen me sigurinë dhe sigurimin, sistemet dhe përbërësit në të gjitha fazat e zhvillimit të depos së menaxhimit të mbetjeve radioaktive.

3. Niveli i sigurisë për çdo aspekt të përmendur në paragrafët më sipër të jetë i përshtatur me nivelin e riskut.

4. Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive duhet t'i regjistrojnë ato sipas aneksit V.

5. Sistemi i menaxhimit të specifikoje:

a) rolin e strukturës së menaxhimit dhe asaj organizative që duhet të përdoret për zbatimin e proceseve për të gjitha aktivitetet që lidhen me sigurinë;

b) përgjegjësitë e operatorëve të përfshirë në procesin e menaxhimit dhe zbatimit, si dhe vlerësimin e të gjithë punës që lidhet me sigurinë.

6. Sistemi i menaxhimit të sigurojë:

a) përgatitjen dhe ruajtjen e evidencave të dokumentacionit për të demonstruar që cilësia e domosdoshme është arritur, që elementet përbërëse janë vendosur dhe përdorur në përputhje me specifikimet e përshtatshme, që mbetjet e paketuara dhe mbetjet e papaketuara përputhen me nivelet e çlirimit të mbetjes dhe që ato janë trajtuar siç duhet, janë ruajtur ose vendosur në depon përfundimtare;

b) grumbullimin e të dhënave dhe gjithë informacionin lidhur me sigurinë, ruajtjen e tij në të gjithë hapat e zhvillimit e të funksionimit të depos.

Neni 7

Trajnimi

Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive, si dhe të licencuarit për depon e

menaxhimit të mbetjeve radioaktive të marrin masat e përshtatshme për trajnimin e personelit, i cili merret me menaxhimin e mbetjeve radioaktive sipas programeve të miratuara të trajnimit.

Neni 8

Sigurimi

1. Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive, si dhe të licencuarit për depon e menaxhimit të mbetjeve radioaktive të marrin të gjitha masat për të garantuar sigurimin e të gjitha mbetjeve radioaktive që kanë në posedimin apo kontrollin e tyre, në mënyrë që të garantojnë:

a) parandalimin e çdo veprimi të paautorizuar në zonën e ruajtjes së mbetjeve radioaktive;

b) parandalimin e hyrjes së mbetjeve radioaktive të paautorizuara në depo;

c) mbrojtjen e mbetjeve radioaktive nga vjedhja, humbja apo aktet sabotuese.

2. Masat e sigurisë dhe masat e sigurimit të zbatohen në mënyrë të integruar.

3. Niveli i sigurimit të jetë proporcional me nivelin e rreziqeve radiologjike dhe natyrën e mbetjeve radioaktive.

Neni 9

Përgatitja dhe reagimi në raste emergjence

1. Të licencuarit për depon e menaxhimit të mbetjeve radioaktive të krijojnë një plan dhe procedura të reagimit në raste emergjence në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e komunitetit dhe mjedisin në rast të lindjes së problemeve gjatë menaxhimit të mbetjeve radioaktive nga prodhimi, në vendosjen në depon përfundimtare dhe deri në eliminimin dhe reduktimin e plotë të rrezikut dhe dëmeve të shkaktuara në komunitet dhe mjedis.

2. Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive të marrin parasysh në planin dhe procedurat e reagimit në raste emergjence mbetjet radioaktive të pranishme, trajtimet që i bëhen mbetjes radioaktive, si dhe depon e menaxhimit të mbetjeve radioaktive.

Neni 10

Transporti i mbetjeve radioaktive

Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive sigurojnë transportin e mbetjeve radioaktive në rrugë tokësore (rrugë publike, linja



hekurudhore), rrugë ajrore ose rrugë detare në përputhje me rregulloren në fuqi për transportin e sigurt të lëndëve radioaktive.

Neni 11

Menaxhimi i mbetjeve radioaktive

Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive, si edhe të licencuarit për depon e menaxhimit të mbetjeve radioaktive identifikojnë dhe marrin në konsideratës gjatë menaxhimit të mbetjeve radioaktive, të gjitha rreziqet radiologjike dhe joradiologjike të lidhura me mbetjen radioaktive, ku përfshihen rreziqet biologjike, kimike ose rreziqet nga lëndët ndezëse dhe duhet të jenë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret që kanë të bëjnë me rreziqet e përmendura më sipër.

Neni 12

Financimi i menaxhimit të mbetjeve radioaktive

Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive të sigurojnë fondet për të mbuluar kostot lidhur me menaxhimin e mbetjeve radioaktive që ato prodhojnë.

Neni 13

Transparenca

Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive, si dhe të licencuarit për depon e menaxhimit të mbetjeve radioaktive të sigurojnë që punëmarrësit dhe publiku ka informacionin e nevojshëm për të treguar që mbetja radioaktive nën zotërimin ose kontrollin e tij është menaxhuar në mënyrë të sigurt, duke parashikuar që një informacion i tillë nuk prek sigurinë dhe sigurimin e mbetjeve radioaktive.

PJESA II

MENAXHIMI I MBETJEVE RADIOAKTIVE

Neni 14

Kushtet e përgjithshme për kontrollin e prodhimit të mbetjeve radioaktive

1. Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive duhet të sigurojnë identifikimin dhe kontrollin e mbetjeve radioaktive, në termat e vëllimit dhe i përmbajtjes së radioaktivitetit.

2. I licencuari në lidhje me të dhënat për burimet e konsumuara dhe mbetjet radioaktive përdor formatin në aneksin III.

3. Të licencuarit duhet të konsiderojnë masat e mëposhtme të kontrollit sipas rendit të mëposhtëm:

a) të reduktojnë prodhimin e mbetjeve radioaktive;

b) të ripërdorin burimet radioaktive kur është e mundur;

c) të riciklojnë burimet radioaktive që nuk përdoren më;

ç) të çlirojnë materialin radioaktiv nga kontrolli rregullator dhe të sigurojnë që derdhjet e shkarkimet radioaktive në mjedis janë brenda limiteve të lejuara të shkarkimit;

d) të vendosin në depon përfundimtare mbetjet radioaktive.

Neni 15

Minimizimi i prodhimit të mbetjeve radioaktive

1. Aktivitetet që prodhojnë mbetje radioaktive të planifikohen në mënyrë të tillë që vëllimi dhe përmbajtja e mbetjes radioaktive të jetë në minimumin e mundshëm.

2. Të licencuarit për aktivitetet që prodhojnë mbetje radioaktive duhet të sigurojnë që prodhimi i mbetjeve radioaktive dhe ndikimi i tyre në mjedis të mbahen në minimumin e mundshëm.

Neni 16

Ripërdorimi dhe riciklimi i burimeve që nuk përdoren më

1. Të licencuarit për aktivitetet që prodhojnë mbetje radioaktive përpara se të deklarojnë burimet që nuk përdoren më si mbetje radioaktive të marrin në konsideratë nëse ai ose çdo person tjetër mund të përdorë ose të riciklojë këto burime.

2. Në qoftë se i licencuari vendos të transferojë burimet që nuk i përdor më për riciklim ose ripërdorim te një person tjetër, i licencuari duhet të marrë aprovim nga KMR-ja përpara transferimit të tyre.

3. I licencuari duhet të sigurojë që personi, tek i cili do të transferohen burimet që nuk përdoren më, të ketë licencë të vlefshme të lëshuar nga KMR-ja për të përdorur ose për të ricikluar këto burime.

4. I licencuari mund të deklarojë burimet radioaktive të papërdorshme si mbetje radioaktive.

5. I licencuari duhet të marrë aprovim nga KMR-ja përpara se të dërgojë mbetjet radioaktive te



depoja e menaxhimit të mbetjeve radioaktive, e licencuar nga KMR-ja.

6. I licencuari, që transferon burimet që nuk përdoren më ose mbetjet radioaktive dhe i licencuari që mori burimet që nuk përdoren më ose mbetjet radioaktive, duhet të dokumentojnë transferimin e zotërimit të burimit që nuk përdoret më ose të mbetjes radioaktive.

Neni 17

Kthimi i burimeve që nuk përdoren më

1. Personat që kanë plan të marrin burim të mbyllur radioaktiv:

a) i kërkojnë furnizuesit të përfshijë një kusht në kontratën e blerjes ose në dokumentin e çlirimit të burimit si dhurim, të pranojë kthimin e burimit pas periudhës së përdorimit të tij;

b) të paraqesë një kopje të pjesëve përkatëse në kontratë ose dokumentin e çlirimit në KMR, si pjesë e dokumentacionit të licencimit, para blerjes së burimit.

2. Në qoftë se i licencuari nuk mund ta kthejë burimin te furnizuesi, atëherë duhet të marrë në konsideratë ripërdorimin, riciklimin ose, dhe kur kjo është e pamundur, ta deklarojë si mbetje radioaktive në përputhje me dispozitat përkatëse.

3. I licencuari të mbajë në kontroll çdo burim që nuk përdoret më.

Neni 18

Heqja nga kontrolli rregullator

Burimet, materialet dhe çdo objekt tjetër radioaktiv që nuk përdoret më mund të hiqen nga kontrolli rregullator, me kusht që:

a) përqendrimet e aktivitetëve të mos kalojnë nivelet e çlirimit, të përcaktuara në aneksin I;

b) përqendrimet e aktivitetit të përputhen me nivelet specifike të çlirimit dhe kërkesat e lidhura për materiale specifike ose për materiale që vijnë nga llojet e praktikave të veçanta të vendosura nga KMR-ja, përveç niveleve të përgjithshme të çlirimit të përcaktuara në aneksin I. Heqja e këtyre materialeve nga kontrolli rregullator aprovohet nga KMR-ja, rast pas rasti.

Neni 19

Ndalimi i hollimit të mbetjeve radioaktive

Ndalohet hollimi i qëllimshëm i mbetjeve radioaktive, përveçse në rastet e përzierjes së

materialeve të ndryshme me lëndë radioaktive gjatë punës. Nuk lejohet hollimi i shkarkimit të derdhjeve të lëngëta apo në formë hiri me qëllim uljen e përqendrimit të aktivitetit nën limit. Në qoftë se përqendrimi i aktivitetit është nën limit, me qëllim uljen e rreziqeve mund të bëhet një hollim i kontrolluar.

Neni 20

Shkarkimi i mbetjeve radioaktive

1. Ndalohet hedhja dhe transferimi në mjedis i mbetjeve të ngurta radioaktive që kalojnë nivelet e çlirimit, të përcaktuara në aneksin I. Në këtë rast, mbetjet radioaktive vendosen në depo të përshtatshme, të licencuara nga KMR-ja.

2. Transferimi në mjedis i mbetjeve radioaktive të lëngëta dhe në formë hiri bëhet vetëm në qoftë se respektohen kushtet e mëposhtme:

a) aktiviteti i përgjithshëm ose përqendrimet e aktivitetit nuk i kalojnë kufijtë e shkarkimeve;

b) derdhjet në formë të lëngët të jenë në formën e solucionëve neutrale, të mirëpërziera me ujë dhe që nuk përmbajnë materiale pezull, materiale helmuese (toksike) ose materiale të tjera të rrezikshme që kalojnë kufijtë ligjorë;

c) të gjitha shkarkimet radioaktive të mbahen në nivele sa më të ulëta që të jetë e mundur, gjithmonë nën nivelet e çlirimit;

ç) të gjitha shkarkimet radioaktive vëzhgohen me detaje dhe me saktësi të mjaftueshme në përputhje me kufijtë e aprovuar të shkarkimeve;

d) të gjitha shkarkimet radioaktive dhe vlerësimet e ekspozimit të popullatës dokumentohen dhe raportohen periodikisht në KMR;

dh) sa herë që KMR-ja kërkon të kryhet monitorimi i shkarkimeve radioaktive, nëpërmjet monitorimit mjedisor, sipas mënyrës së aprovuar nga KMR-ja.

3. Në qoftë se kufijtë e shkarkimit dhe kushtet nuk përmbushen, i licencuari të depozitojë përko-hësisht derdhjet radioaktive dhe të marrë një nga masat e mëposhtme, më të përshtatshme:

a) të presë për zbërthimin radioaktiv të tyre për radiobërthamat me periode të vogël gjysmë-zbërthimi, në qoftë se radiobërthamat kalojnë kufirin e shkarkimit;

b) të filtrojë derdhjet; ose

c) të sigurojë trajtimin e përshtatshëm të tyre.

4. Për çdo shkarkim në mjedis mbahet një proces verbal sipas formatit në aneksin IV



Neni 21

Mbetjet radioaktive të papërshtatshme për ripërdorim, riciklim, shkarkim ose çlirim në mjedis

Mbetjet radioaktive, të cilat për shkak të karakteristikave të tyre nuk janë të përshtatshme për ripërdorim, riciklim, për çlirim nga kontrolli rregullator ose shkarkim, të përpunohen si mbetje radioaktive në depot e trajtimit të mbetjeve të licencuara nga KMR-ja.

Neni 22

Karakteristikat e mbetjeve radioaktive

1. Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive të përshkruajnë karakteristikat fizike, mekanike, kimike, radiologjike dhe biologjike të mbetjes radioaktive.

2. Karakteristikat e përshkruara të mbetjes radioaktive të regjistrohen nga të licencuarit në mënyrë të tillë që të lehtësojnë menaxhimin e mëtejshëm të saj. Të dhënat të mbahen sipas formatit në aneksin III, të ruhen në ambientet e të licencuarit dhe t'u vihen në dispozicion operatorëve për trajtimin e mbetjeve, si dhe trupës rregullatore.

Neni 23

Klasifikimi i mbetjeve radioaktive

1. Mbetjet radioaktive klasifikohen duke marrë në konsideratë hapat e mëtejshëm deri në vendosjen në depon përfundimtare, sipas grupeve të dhëna në aneksin II, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje.

2. Burimet radioaktive të konsumuara, të konfirmuara si mbetje, do të klasifikohen sipas aneksit VI, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje.

3. Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive të vendosin dhe të zbatojnë një klasifikim të mbetjeve radioaktive, bazuar në klasifikimin e dhënë në aneksin II, si dhe duke përdorur nivelet e mëposhtme kur është e mundur të përcaktohet:

a) origjina e mbetjeve radioaktive, përfshirë instalimin, strukturën, sistemin ose elemente që gjenerojnë mbetje radioaktive;

b) llojet e mbetjeve radioaktive, përfshirë filtrat, elementet e përdorura, strukturat e prishura, mbeturina të ndryshme, burime radioaktive të konsumuara, mbetje të tjera;

c) cilësitë radiologjike të mbetjeve, përfshirë shkallën e dozës së ambientit, ndotjen sipërfaqësore, përqendrimin e aktivitetit, përbërjen e radiobërthamës dhe periodën e gjysmëzbërthimit të radiobërthamës mbizotëruese;

ç) cilësi të tjera, veç atyre radiologjike, përfshirë rreziqet fizike, biologjike, kimike, gërryerjen, përmbajtjen e lëngjeve të lira, avullimin, vetitë ndezëse, formimin e gazit dhe përmbajtjen e tij, tretshmërinë, afinitetin, përmbajtjen e substancave organike dhe praninë e substancave të tjera të rrezikshme;

d) mundësitë vijuese të menaxhimit, përfshirë ngjeshjen, djegien, imobilizimin, ndarjen, dekontaminimin, pastrimin ose shkrirjen.

Neni 24

Ndarja e mbetjeve radioaktive

1. Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive të sigurojnë që ndarja e mbetjeve radioaktive të bëhet në përputhje me skemën e klasifikimit.

2. Pas ndarjes, grupimet e mbetjeve radioaktive të mbahen të ndara, në lloje, tipa të ndryshëm kontejnerësh.

3. Kontejnerët të jenë të fortë dhe të përshtatshëm në përputhshmëri me kategorinë e mbetjeve radioaktive dhe të lejojnë mbushjen dhe zbrazjen e sigurt gjatë periudhës së pritshme të ruajtjes.

4. Kontejnerët të vendosen në vende të arritshme brenda zonave të kontrolluara dhe të kenë të shënuar qartë simbolin e rrezatimit dhe klasën e mbetjes radioaktive.

5. Pas mbushjes, çdo kontejner të peshohet dhe të ketë të shënuar përshkrimin e mbetjes radioaktive.

6. Përpara çdo ripërdorimi të kontejnerit të kontrollohet ndotja sipërfaqësore brenda dhe jashtë tij.

7. I licencuari duhet të dokumentojë dhe të mbajë regjistrat e të gjithë kontejnerëve me mbetje radioaktive të prodhuara gjatë punës.

8. Dokumentet e specifikuara në pikën 7 të përfshijnë:

a) numrin e përgjithshëm të kontejnerëve për çdo klasë të mbetjeve radioaktive, të prodhuar në një vit;



b) masën totale të çdo klase të mbetjeve radioaktive, të prodhuar në një vit;

c) vëllimin total të çdo klase të mbetjeve radioaktive, të prodhuar në një vit;

ç) aktivitetin e përgjithshëm të çdo klase të mbetjeve radioaktive, të prodhuar në një vit;

d) përbërjen e radiobërthamës të çdo kategorie të mbetjeve radioaktive, të prodhuar në një vit, në qoftë se është e mundur me aktivitetin për çdo radiobërthamë;

dh) origjinën/at e mbetjeve për çdo klasë;

e) rreziqet e tjera të pranishme ose të mundshme (kimike, biologjike ose ndezëse), lidhur me çdo klasë të mbetjeve radioaktive, sipas rastit.

Neni 25

Trajtimi dhe kondicionimi

1. Të licencuarit për aktivitete, që prodhojnë mbetje radioaktive, të sigurojnë trajtimin dhe kondicionimin e mbetjeve radioaktive e, në qoftë se është e nevojshme, të përmirësojnë karakteristikat e mbetjeve radioaktive me qëllim që të përmbushin nivele të çlirimit në ruajtjen e përkohshme ose në depon përfundimtare.

2. Trajtimi dhe kondicionimi i mbetjeve radioaktive të kryhet nga i licencuari në ambientet e përshtatshme të menaxhimit të mbetjeve radioaktive, të autorizuar nga KMR-ja në bashkëpunim me drejtorinë rajonale të mjedisit në qark dhe bashkinë përkatëse.

3. Mbetjet radioaktive të përpunohen në mënyrë të tillë që forma e fituar e mbetjes të ruhet apo të rimerret në mënyrë të sigurt në çdo fazë të saj, deri në vendosjen e saj në depon përfundimtare.

4. Të licencuarit e depove të menaxhimit të mbetjeve radioaktive të marrin masa për identifikimin, vlerësimin dhe si të veprojnë me mbetjet radioaktive të cilat nuk përmbushin nivelet e çlirimit të tyre.

5. Mbetjet radioaktive dytësore të cilat mund të prodhohen gjatë trajtimit dhe kondicionimit të mbetjeve radioaktive merren në konsideratë nga i licencuari dhe trajtohen përsëri në përputhje me këtë rregullore.

Neni 26

Paketimi

1. Të licencuarit të sigurojnë që mbetjet radioaktive të trajtuara dhe të kondicionuara, janë paketuara në pako sipas kriterave të propozimit në

ruajtje të përkohshme, transport ose depo përfundimtare.

2. Pakot e mbetjeve radioaktive të prodhohen në mënyrë të tillë që materiali radioaktiv të jetë i sigurt si gjatë një procesi normal ashtu edhe gjatë një aksidenti që mund të ndodhë gjatë trajtimit, transportit, ruajtjes së përkohshme ose vendosjes në depon përfundimtare.

3. KMR-ja miraton prodhimin e një tipi të veçantë paketimi gjatë procesit të licencimit të depos së menaxhimit të mbetjeve radioaktive, bazuar në dokumentet e mëposhtme, që do të paraqesë aplikanti:

a) skicim dhe përshkrim të paketimit;

b) rezultatet e çdo testi të kryer për paketimin;

c) çdo dokument tjetër që konfirmon qëndrueshmërinë e paketimit për qëllimin e caktuar.

4. Çdo pako që përmban mbetje radioaktive të ketë të shënuar simbolin e rrezatimit.

5. Çdo pako që përmban mbetje radioaktive të jetë e emërtuar me të dhënat e mëposhtme:

a) një numër unik identifikimi;

b) peshën e pakos;

c) klasën e mbetjes radioaktive;

ç) maksimumin e fuqisë së dozës, të matur në kontakt me sipërfaqen e jashtme.

6. Simboli i rrezatimit i specifikuar në pikën 4 dhe etiketat e specifikuara në pikën 5 të fiksohen dhe të vendosen në vende të dukshme, qartësisht të lexueshme e të jenë cilësore, të qëndrueshme për hapat e mëtejshëm të menaxhimit të mbetjeve radioaktive.

Neni 27

Kushtet e përgjithshme për ruajtjen e përkohshme

1. Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive mund të ruajnë mbetjen radioaktive deri në transferimin në depon e menaxhimit të mbetjeve radioaktive ose deri në heqjen nga kontrolli rregullator në një depo për ruajtje të përkohshme që gjendet në ambientet e tij, në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes nga rrezatimet.

2. Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive të sigurojnë ruajtjen e përkohshme të mbetjeve radioaktive në depo të përshtatshme, të licencuara nga KMR-ja.

3. Të licencuarit e depos së ruajtjes së përkohshme të sigurojnë që mbetja radioaktive



është ruajtur në kushte të tilla që të mund të inspektohet, të monitorohet, të rimerret dhe të ruhet gjatë periudhës së ruajtjes së përkohshme, duke marrë në konsideratë menaxhimin e mëtejshëm.

4. Të licencuarit e depos së ruajtjes së përkohshme, duhet:

a) të marrin masat e përshtatshme për të parandaluar degradimin e përmbajtjes së mbetjes radioaktive, sidomos për ruajtje të përkohshme për një kohë të gjatë;

b) të bëjnë rishikime periodike të kapacitetit të depos së ruajtjes së përkohshme, duke marrë parasysh mbetjet e parashikuara që krijohen nga procese normale dhe të tjera, për të vlerësuar jetëgjatësinë e depos për ruajtjen e përkohshme dhe disponueshmërinë e depos për ruajtjen e përhershme;

c) të verifikojnë nëpërmjet inspektimeve periodike që paketimi është i përshtatshëm për ruajtjen e përkohshme sipas frekuencave dhe metodave të specifikuara në raportin vlerësues të procesit të licencimit të depos për ruajtjen e përkohshme.

5. Vetëm mbetjet radioaktive që kanë plotësuar nivelet e çlirimit të aprovuara nga KMR-ja lejohen në depon e ruajtjes së përkohshme.

6. Ruajtja e përkohshme e mbetjeve radioaktive lejohet vetëm me paketime të aprovuara për ruajtje të përkohshme.

Neni 28

Depot e ruajtjes së përkohshme

1. Depot e ruajtjes së përkohshme të jenë të sigurt, të qëndrueshme dhe të garantuara nga pikëpamja e sigurimit fizik përpara se mbetja radioaktive të vendoset në të.

2. Të licencuarit për depot e ruajtjes së përkohshme të mbetjeve radioaktive të sigurojnë për krijimin dhe operimin e depos në mënyrë të tillë që të mbajnë nën kontroll mbetjet radioaktive.

3. I licencuari të marrë masa që të garantojë funksionimin e proceseve të sigurisë dhe që këto procese të mirëmbahen gjatë gjithë periudhës së operimit të depos, duke marrë në konsideratë, që:

a) mbetja radioaktive të jetë e palëvizshme;

b) të adaptohet një metodë me shumë shtresa që të sigurojë mbajtjen nën kontroll të të gjitha elementeve;

c) forma e mbetjes radioaktive dhe përmbajtja e saj të jenë rezistente ndaj degradimit;

ç) paketimi i mbetjes radioaktive të jetë lehtësisht i inspektueshëm dhe i rigjenerueshëm për inspektim;

d) sistemet e sigurisë të ndërtohen që të realizohet funksionimi i sigurisë në përputhje me kërkesat për monitorimin dhe mirëmbajtjen;

dh) ndërtesa e depos së ruajtjes së përkohshme të jetë rezistente ndaj rreziqeve që merren në konsideratë në vlerësimin e sigurisë;

e) ambienti dhe mjedisi i depos nuk ndikon negativisht në vetitë e mbetjes radioaktive, në paketimin e mbetjes radioaktive ose në sistemin e ruajtjes;

ë) depoja e ruajtjes së përkohshme të mundësojë rikthimin e mbetjes radioaktive;

f) kontrolli i sigurimit dhe kontrolli i hyrjes të jenë në përputhje me masat e sigurimit që aplikohen në depo;

g) jetëgjatësia e depos së ruajtjes së përkohshme të jetë e përshtatshme për periudhën e përcaktuar të ruajtjes.

Neni 29

Zbërthimi në depon e ruajtjes së përkohshme

1. Të licencuarit për aktivitete dhe subjektet që prodhojnë mbetje radioaktive të marrin në konsideratë zbërthimin e mbetjes radioaktive në depo të ruajtjes së përkohshme.

2. Kur gjatë fazës së zbërthimit në depon e ruajtjes së përkohshme përqendrimi i aktivitetit të radionuklidit ulet nën nivelet e çlirimit ose limiteve të autorizuar të shkarkimit, mbetja radioaktive çlirohet nga kontrolli rregullator, duke vëzhguar çdo kriter çlirimi tjetër të vendosur nga KMR-ja.

Neni 30

Ruajtja për kohë të gjatë

1. Depot e ruajtjes së përkohshme të mbetjeve radioaktive, të licencuara, mund të funksionojnë për më shumë se 30 vjet, duke siguruar që:

a) gjatë fazës së krijimit të depos duhen marrë në konsideratë karakteristikat pasive të sigurisë, sepse degradimi, prishja e këtyre karakteristikave gjatë periudhës së funksionimit të depos cenon sigurinë;

b) gjatë projektimit të depos në përzgjedhjen e materialeve të ndërtimit merren në konsideratë impakti i kohës, gërryerja, lodhja e metaleve, tkurrja, ndryshimet e indikuara nga trezimi etj.

2. Të licencuarit për depon e përkohshme të mbetjeve radioaktive sigurojnë:



a) një program menaxhimi cilësor që adreson vjetërsinë lidhur me degradimin e depos dhe sistemeve, strukturave dhe përbërësve të saj për mbajtjen nën kontroll të mbetjes radioaktive, që përfshin parashikimet për monitorimin e nevojshëm, që siguron detektim të hershëm të çdo mangësie;

b) një plan për trajtimin e sigurt të mbetjeve radioaktive për periudhën e ruajtjes së përkohshme, i cili merr në konsideratë efektet e mundshme të degradimit të mbetjes radioaktive ose çdo element të sistemit të kontrollit të aftësisë së mbetjes radioaktive për t'u ripërdorur.

Neni 31

Vendosja në depo përfundimtare të mbetjes radioaktive

1. Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive të sigurojnë vendosjen përfundimtare të mbetjes radioaktive në një depo të përshtatshme të mbetjeve radioaktive, të licencuar nga KMR-ja.

2. Vendosja në depo përfundimtare e mbetjeve radioaktive lejohet vetëm me paketime të aprovuara për depo.

3. Krijimi i depos përfundimtare përcaktohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Neni 32

Menaxhimi i mbetjeve radioaktive të nivelit të ulët

1. Të licencuarit për aktivitete që prodhojnë mbetje të nivelit shumë të ulët mund t'i depozitojnë ato afër sipërfaqes së tokës, me miratim të drejtorisë rajonale të mjedisit dhe aprovim të bashkisë përkatëse në territorin e të cilit bëhet depozitimi.

2. Zbatimi i kritereve të pranimit të demonstron në KMR.

PJESA III LICENCIMI I SUBJEKTEVE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE RADIOAKTIVE

Neni 33

Licencimi i subjekteve

1. Të gjithë personat fizikë a juridikë që do të fillojnë një aktivitet që prodhon mbetje radioaktive, duhet të pajisen paraprakisht me licencë nga KMR-

2. Licencat e lëshuara nga KMR-ja për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive mbulojnë mënyrën e menaxhimit të mbetjeve radioaktive në depo nga i licencuari, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

3. Licenca e lëshuar nga KMR-ja për funksionimin e depove të menaxhimit të mbetjeve radioaktive, i jep të drejtën të licencuarit të kryejë aktivitetin e menaxhimit të mbetjeve radioaktive për të cilin depoja është ndërtuar.

Neni 34

Njoftimi

1. Çdo person, që ka për qëllim të fillojë ndërtimin e një depoje për menaxhimin e mbetjeve radioaktive, duhet të njoftojë, me shkrim, për këtë qëllim, KMR-në dhe bashkinë përkatëse në territorin e të cilit do të ndërtohet depozitimi.

2. Personi i cili bën këtë kërkesë është përgjegjës për fillimin e komunikimit me KMR-në, në mënyrë që të marrë të gjithë informacionin e duhur për dokumentacionin që duhet të dorëzojë dhe veprimet që duhet të kryejë për procesin e licencimit, përveç kërkesave të kësaj rregulloreje.

Neni 35

Aplikimi për licencë

1. Çdo person juridik ose fizik që ka për qëllim të fillojë ndërtimin e një depoje për menaxhimin e mbetjeve radioaktive dërgon në KMR aplikimin për licencë, i cili duhet të përfshijë, minimalisht, informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe kontaktet e personit që po aplikon për licencë;

b) qëllimin e aplikimit ku identifikohet aktiviteti, përshkrimin e depos që do të ndërtohet dhe një plan të ndërtimit të depos.

2. Aplikimi duhet të ketë dokumentet e mëposhtme:

a) një dosje sigurie që përfshin një raport-ekspertizë të sigurisë dhe sigurimit, i cili bëhet nga personi juridik ose fizik, si dhe të gjitha dokumentet specifike për çdo fazë të ndërtimit të depos, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje;

b) çdo dokument tjetër që kërkohet nga KMR-ja.

3. Dosja e sigurisë, e cila i bashkëngjitet aplikimit për licencë, është pjesë e pandarë e licencës.



4. Licenca për depon e menaxhimit të mbetjeve radioaktive lëshohet vetëm nëse aplikanti i plotëson kushtet e mëposhtme:

a) të demonstrojë përmbushjen e të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi;

b) të provojë se ai ka aparaturat dhe teknologjinë e nevojshme, si dhe burimet financiare;

c) të provojë se ka aftësi organizative dhe përgjegjësi për parandalimin e kufizimin e pasojave në rast aksidenti;

ç) të provojë se ka implementuar një sistem menaxhimi duke adresuar të gjitha çështjet e rëndësishme për sigurinë dhe është në gjendje të ushtrojë kontroll efektiv dhe të mbikëqyrë punën e kryer të furnizuesve të tij me produkte dhe shërbime;

d) të provojë me detyra të rëndësishme për sigurinë se stafi i tij ka kualifikimin e duhur profesional dhe kompetenca;

dh) të marrë të gjitha masat e nevojshme në nivelin e standardeve aktuale teknike në fuqi për të parandaluar ndodhjen e aksidenteve;

e) të marrë masat e përshtatshme dhe të mjaftueshme financiare për grumbullimin, transportin, trajtimin, kondicionimin dhe ruajtjen e mbetjeve radioaktive të prodhuara nga aktivitetet e tij, si dhe për mbylljen ose çmontimin e depos, sipas rastit;

ë) të krijojë dhe të mirëmbajë një sistem informimi publik në përputhje me legjislacionin në fuqi;

f) të informojë organet e qeverisjes vendore në territorin e të cilit zhvillon veprimtarinë e tij, për çdo problem që ka lidhje me rrezikimin e komunitetit apo mjedisit.

Neni 36

Fazat e procesit të licencimit

Personat e interesuar për licencë të depos së menaxhimit të mbetjeve radioaktive duhet të plotësojnë dokumentacionin e përshtatshëm për të marrë nga KMR-ja dhe KRRT-ja e bashkisë, në territorin e të cilit do të bëhet ndërtimi i depos, aprovimet e mëposhtme:

a) aprovimin e vendit të ndërtimit;

b) aprovimin e ndërtimit;

c) licencën për kompletimin dhe fillimin e aktivitetit;

ç) licencën e funksionimit;

d) aprovimin për funksionim jashtë kohës së operimit të depos së përkohshme;

dh) aprovimin për çmontimin e depos së përkohshme;

e) licencën për mbylljen e depos përfundimtare.

Neni 37

Kushtet e revokimit, heqjes së licencës

1. Licencimet e depove të menaxhimit të mbetjeve radioaktive janë të vlefshme vetëm për aktivitetet dhe objektet për të cilat janë lëshuar.

2. Skadimi, pezullimi ose revokimi i licencës nuk e shkarkon mbajtësin e licencës ose personin që ka marrë përsipër pronësinë mbi mbetjet radioaktive apo mbi objektet e menaxhimit të mbetjeve radioaktive, sipas rastit, e shpjeguar kjo, detyrimet e të licencuarit të parashikuara në ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar dhe në këtë rregullore.

Neni 38

Plani i menaxhimit emergjent dhe i sigurisë për të gjitha fazat e riskut

1. Çdo aplikant për licencë për depo të menaxhimit të mbetjeve radioaktive përgatit si pjesë të aplikimit një dosje të sigurisë dhe një vlerësim mbështetës të sigurisë që mbulon të gjitha fazat e zhvillimit të depos.

2. Paketa e dokumentacionit të sigurisë dhe vlerësimi mbështetës për sigurinë e depos së përhershme të mbetjeve realizon sigurinë e depos gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të saj dhe pas mbylljes së depos, me qëllim demonstrimin në mënyrë të veçantë se si siguria do të garantohet në mënyrë pasive në masën maksimale të mundshme.

3. Përmasat dhe niveli i detajeve të paketës së dokumentacionit të sigurisë dhe vlerësimit mbështetës të sigurisë të jenë proporcionale me kompleksitetin e funksioneve dhe rëndësinë e rreziqeve që lidhen me depon ose aktivitetin përkatës.

4. Paketa e dokumentacionit të sigurisë dhe vlerësimi mbështetës i sigurisë të përshkruajë të gjitha aspektet e sigurisë së vendndodhjes, skicën e objektit, masat menaxhuese të kontrollit dhe kontrollet rregullatore.

5. Paketa e dokumentacionit të sigurisë dhe vlerësimi mbështetës i sigurisë të demonstrojë nivelin e mbrojtjes së parashikuar dhe të ofrojë



siguri për KMR-në dhe palët e tjera të interesuara, që këto kërkesa do të plotësohen.

6. Paketa e dokumentacionit të sigurisë dhe vlerësimi mbështetës i sigurisë të dokumentohen në nivel të detajuar dhe me një cilësi të mjaftueshme për të demonstruar e për të mbështetur vendimet që do të bëhen në çdo hap në zhvillimin e depos dhe për të lejuar një rishikim të pavarur.

7. Dokumentacioni i paketës së sigurisë të jetë i shkruar në mënyrë të qartë dhe të përfshijë argumente që justifikojnë qasjet e vëna re gjatë zhvillimit të dosjes së sigurisë, në bazë të informacionit të gjurmueshëm.

8. Paketa e dokumentacionit të sigurisë të specifikojë standardet e aplikuara për vlerësimin e sigurisë.

9. KMR-ja miraton paketën e dokumentacionit të sigurisë dhe vlerësimin mbështetës të sigurisë gjatë procesit të licencimit të depos së menaxhimit të mbetjeve radioaktive.

10. Paketa e dokumentacionit të sigurisë dhe vlerësimi mbështetës i sigurisë të përditësohen gjatë kohës së punës së depos apo aktivitetit dhe në rast të çdo ndryshimi që mund të ndikojë në siguri.

Neni 39

Amendimi i licencës

1. Të licencuarit për depot e menaxhimit të mbetjeve radioaktive që kanë ndërmend modifikimin e depos, veprimtarisë ose organizimit të saj, të cilat mund të ndikojnë në sigurinë e depos ose të çojnë në ndryshime të dosjes së sigurisë, të paraqesin një kërkesë në KMR për amendim të licencës.

2. Kërkesa të përfshijë informacionin e përditësuar, siç specifikohet në nenin 36 dhe të shoqërohet nga dokumente që përshkruajnë plotësisht ndryshimet e dëshiruara, arsyetimet për modifikimet e propozuara, së bashku me një raport të përditësuar të vlerësimit të sigurisë.

3. Pas shqyrtimit të aplikimeve, KMR-ja të marrë një vendim për miratimin e amendimit të licencës.

4. I licencuari të implementojë ndryshimet e propozuara vetëm pasi është marrë miratimi nga KMR-ja.

Neni 40

Vendndodhja dhe përshkrimi i depos së përkohshme

1. Të licencuarit që do të ngrenë depo të përkohshme të trajtimit të mbetjeve radioaktive, të përcaktojnë vendndodhjen dhe përshkrimin e depos, në mënyrë të tillë që të garantohet siguria gjatë funksionimit dhe çmontimit të saj në kushte normale funksionimi dhe gjatë aksidenteve.

2. I licencuari të sigurojë që vetitë, inventari i përgjithshëm dhe të gjitha rreziqet e mundshme radiologjike dhe joradiologjike, që lidhen me mbetjet radioaktive, të merren në konsideratë gjatë përshkrimit të depos.

3. I licencuari të sigurojë që nevoja për mirëmbajtjen operative, testimin, inspektimin dhe ekzaminimin të adresohet duke filluar nga faza e projektimit konceptual.

Neni 41

Karakteristikat e vendndodhjes

1. Të licencuarit për të ngritur një depo të përkohshme të menaxhimit të mbetjeve radioaktive duhet të përshkruajnë vendin e zgjedhur në detaje të mjaftueshme për të mundësuar kuptimin e karakteristikave të vendndodhjes dhe evolucionin e saj në kohë, duke përfshirë edhe aspektet e mëposhtme:

- a) kushtet e tij aktuale;
- b) evolucionin apo ngjarjet natyrore të mundshme që mund të ndikojnë në sigurinë e tij;
- c) aktivitetet e mundshme njerëzore në afërsi të vendit që mund të ndikojë sigurinë e saj.

2. I licencuari të sigurojë që përshkrimi i vendndodhjes është përqendruar në ato karakteristika, ngjarje dhe procese që mund të ndikojnë në sigurinë e depos së menaxhimit të mbetjeve radioaktive, siç janë të identifikuar në dosjen e sigurisë.

3. I licencuari të sigurojë që rezultatet e karakterizimit të vendndodhjes të demonstrojnë qëndrueshmërinë gjeologjike, gjeomorfologjike ose topografike të saj, karakteristikat dhe proceset që do të kontribuojnë në sigurinë e saj dhe se karakteristikat, proceset dhe ngjarje të tjera nuk dëmtojnë sigurinë e depos.



Neni 42

Aprovim ndërtimi, nga pikëpamja e sigurisë dhe e sigurimit nga rrezatimet

1. Pas përfundimit të fazës përgatitore për përcaktimin e vendndodhjes, i licencuari do t'i paraqesë KMR-së një kërkesë për "aprovim ndërtimi" në zonën e përcaktuar nga pikëpamja e sigurisë dhe sigurimit nga rrezatimi, i cili do të përfshijë:

- a) raportin fillestar të vlerësimit të sigurisë;
- b) përshkrimin paraprak të depos për menaxhimin e mbetjeve radioaktive;
- c) një sintezë me të dhënat e përshkrimit të depos;
- d) programin e realizimit për punimet e ndërtimit;
- e) limitet dhe kushtet paraprake të funksionimit, duke përfshirë edhe kriteret e pranimit të mbetjeve, siç rezulton nga vlerësimi paraprak i sigurisë;
- dh) planin fillestar të çmontimit për depon e përkohshme të trajtimit të mbetjeve radioaktive;
- e) programet e monitorimit paraoperacional;
- ë) programin e sigurimit të cilësisë për ndërtim;
- f) një procedurë për menaxhimin e modifikimeve;
- g) masat e rishikuara të sigurisë, në përputhje me rregulloret përkatëse;
- gj) programin e rishikuar të menaxhimit të mbetjeve radioaktive;
- h) programin e rishikuar për mbrojtjen nga rrezatimi;
- i) një instrument të sigurisë financiare për kryerjen e të gjitha punëve që kanë të bëjnë me ndërtimin, funksionimin, çmontimin ose mbylljen e depos së menaxhimit të mbetjeve radioaktive, duke përfshirë mbulimin e kostove afatgjata të monitorimit të objektit pas mbylljes së saj.

Neni 43

Ndërtimi i depos së menaxhimit të mbetjeve radioaktive

1. Pas marrjes së aprovimit të ndërtimit, i licencuari të sigurojë ndërtimin e objektit të menaxhimit të mbetjeve radioaktive në përputhje me projektin paraprak të përshkruar në raportin e sigurisë.

2. Të licencuarit për ndërtimin e depos së mbetjeve radioaktive të sigurojnë që objekti të ndërtohet në mënyrë të tillë që mjedisi ku është

ndërtuar të jetë i sigurt në periudhën pas mbylljes së depos, siç është përcaktuar në dosjen e sigurisë.

3. I licencuari duhet të kryejë çdo test të nevojshëm verifikimi të ndërtesës së depos.

4. KMR-ja dhe KRRT-ja e bashkisë, në territorin e të cilit do të bëhet ndërtimi i depos, ka të drejtën për mbikëqyrjen e ndërtimit dhe të jetë pjesë gjatë testeve të verifikimit.

Neni 44

Licenca për fillimin e aktivitetit

Pas përfundimit të ndërtimit të depos i licencuari të dorëzojë në KMR një kërkesë për licencë për fillimin e aktivitetit, të shoqëruar me një dosje sigurie të përditësuar, ku të përfshihen:

- a) raporti paraoperacional i vlerësimit të sigurisë;
- b) skema e testeve të çmontimit;
- c) procedurat e testimit dhe kriteret e pranimit për çdo sistem të rëndësishëm për sigurinë;
- d) një procedurë për menaxhimin e modifikimeve;
- e) një listë e procedurave të kompletimit dhe fillimit të aktivitetit;
- dh) limitet dhe kushtet operationale paraprake, përfshirë edhe kriteret e pranimit të mbetjeve, siç rezulton nga vlerësimi paraprak i sigurisë;
- e) plani i çmontimit për depon e përkohshme të trajtimit të mbetjeve radioaktive ose plani i rishikuar për mbylljen e depos së përhershme;
- ë) rezultatet e programeve të monitorimit paraoperacional;
- f) programet operationale të monitorimit;
- g) programi për sigurimin e cilësisë për kompletimin dhe fillimin e aktivitetit;
- gj) masat e sigurisë, në përputhje me rregulloret përkatëse;
- h) programi i menaxhimit të mbetjeve radioaktive;
- i) programi për mbrojtjen nga rrezatimet;
- j) plani i përgatitjes dhe i reagimit ndaj emergjencave;
- k) programi i trajnimit dhe kualifikimit për stafin.

Neni 45

Fillimi i aktivitetit të depos të menaxhimit të mbetjeve radioaktive

1. Në mënyrë që të marrë aprovimin e KMR-së për fillimin e aktivitetit, i licencuari dorëzon në KMR një aplikim dhe një raport që siguron



evidenca të përfundimit me sukses të testeve të kryera gjatë fazave të fillimit të aktivitetit, duke përfshirë një përshkrim të testeve të kryera dhe orarin e testeve të planifikuara për hapin e ardhshëm të fillimit të aktivitetit.

2. KMR-ja ka të drejtën e mbikëqyrjes së fillimit të aktivitetit të kryer nga i licencuari.

Neni 46

Kompletimi i depos për përdorim

1. Pas përfundimit të kompletimit dhe fillimit të aktivitetit, i licencuari do të përgatitë një raport përfundimtar për të dokumentuar statusin e ndërtimit dhe depos së menaxhimit të mbetjeve radioaktive.

2. Raporti përfundimtar për kompletimin dhe fillimin e aktivitetit të përshkruajë të gjitha testet e kryera dhe të paraqesë rezultatet e tyre dhe çdo modifikim që i është bërë depos së menaxhimit të mbetjeve radioaktive nga faza e lejes së ndërtimit, në mënyrë të tillë që të demonstrojnë pajtueshmërinë me të gjitha kushtet e imponuara në lejen e ndërtimit.

3. Raporti përfundimtar duhet të mirëmbahet nga i licencuari deri në nxjerrjen jashtë përdorimit ose mbylljen e objektit të menaxhimit të mbetjeve radioaktive, kur duhet të përdoret për të zhvilluar planin e çmontimit apo të mbylljes përfundimtare.

Neni 47

Licenca për përdorim

1. Pas kompletimit të depos për përdorim, aplikanti duhet të dorëzojë në KMR një kërkesë që do të përfshijë raportin e sigurisë të përditësuar, si më poshtë:

a) raportin përfundimtar të vlerësimit të sigurisë;
b) raportin përfundimtar të lejes së ndërtimit;
c) përshkrimin e ndërtimit të objektit;
ç) dëshminë e dokumentuar të burimeve financiare të bartësit të autorizimit për të mbuluar të gjitha shpenzimet operative deri në nxjerrjen nga përdorimi ose mbylljen e depos dhe mbikëqyrjen afatgjatë;

d) programin për mirëmbajtjen periodike, testimin dhe inspektimin e sistemeve, strukturave dhe komponentëve të rëndësishëm për sigurinë;

dh) një listë të procedurave operationale;

e) kufizimet operationale, përfshirë nivelet e çlirimit të mbetjeve, siç rezultoi nga vlerësimi përfundimtar i sigurisë;

ë) planin e çmontimit të rishikuar për objektet e depozituara paraprakisht apo planin e rishikuar të mbylljes për objektet e depozitimit;

f) rezultatet e programeve të monitorimit paraoperacional;

g) programet e rishikuara të monitorimit operacional;

gj) programin e rishikuar për mbrojtjen nga rrezatimi;

h) programin për sigurimin e cilësisë;

i) planin e rishikuar të përgatitjes dhe të përgjigjes ndaj emergjencave;

j) programin e rishikuar të menaxhimit të mbetjeve radioaktive;

k) planin konceptual të fazës pas mbylljes së depos;

l) një program për informacione në lidhje me përvojën operationale;

ll) masat e rishikuara të sigurisë, në përputhje me rregulloret përkatëse;

m) programin e rishikuar për trajnimin dhe kualifikimin e stafit.

2. Vlefshmëria e licencës së funksionimit do të vendoset nga plotësimi i kushteve të përcaktuara nga KMR-ja, bazuar në rezultatet e shqyrtimit të tipit të sigurisë të paraqitur në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 48

Funksionimi i depos së menaxhimit të mbetjeve radioaktive

1. Të licencuarit duhet të sigurojnë funksionimin e depos së menaxhimit të mbetjeve radioaktive, në mënyrë të tillë që të ruajnë sigurinë gjatë periudhës së punës të depos dhe, në rast të mbylljes së depos, të ruajnë funksionet e sigurisë deri në çlirimin përfundimtar të zonës.

2. I licencuari do të sigurojë që të gjitha aktivitetet dhe operationet e rëndësishme për sigurinë:

a) janë subjekt i kufizimeve, kushteve dhe kontroleve të dokumentuara;

b) janë bazuar në procedura të dokumentuara;

c) kryhen nga personel i trajnuar, i kualifikuar dhe kompetent.

3. I licencuari të krijojë dhe të zbatojë një program për mirëmbajtjen periodike, testimin dhe inspektimin e atyre sistemeve që janë të rëndësishme për sigurinë, të cilat miratohen nga KMR-ja gjatë procesit të licencimit.

4. I licencuari do të dorëzojë KMR së paku një



tim çdo procedurë tjetër operative të kërkuar nga KMR-ja.

Neni 49

Nivelet e pranimit të mbetjeve

1. I licencuari do të pranojë në depo mbetjet radioaktive që përmbushin kërkesat për pranimin e tyre, të përcaktuara në tipin e sigurisë së depos të miratuar nga KMR-ja.

2. Nivelet e pranimit të mbetjeve do të specifikohen për paketimet individuale dhe për depon e menaxhimit të mbetjeve.

3. Nivelet e pranimit të mbetjeve radioaktive në depon e menaxhimit të mbetjeve do të përcaktojnë kufijtë për karakteristikat e mëposhtme, sipas rëndësisë:

- a) përmbajtjen e radionukleideve dhe përqendrimit të aktivitetit;
- b) dozën e rrezeve gama në ambient dhe në 1 metër distancë nga sipërfaqja e pakos;
- c) ndotjen/kontaminimin sipërfaqësor;
- ç) qëndrueshmërinë e paketimit;
- d) aftësinë koroduese;
- dh) stabilitetin kimik;
- e) efektet e degradimit për shkak të rrezatimit;
- ë) formimin dhe përmbajtjen e gazeve;
- f) përmbajtjen e toksinave;
- g) përmbajtjen e substancave organike me efekt potencial në degradimin mikrobiologjik;
- gj) përmbajtjen e lëngjeve të lira;
- h) prezencën e agjentëve kompleksë;
- i) vetitë shpërthyes;
- j) ndezshmërinë;
- k) rrezikshmërinë.

Neni 50

Mospërputhja me kriteret e pranimit të mbetjeve

I licencuari vendos kriteret për pranimin dhe menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive që miratohen nga KMR-ja. Kriteret e pranimit duhet të jenë në përputhje me llojet e burimeve radioaktive në Shqipëri. Kur ato nuk përputhen, KMR-ja vendos rast pas rasti.

Neni 51

Programet e monitorimit

1. I licencuari do të krijojë, do të zbatojë, do të rishikojë dhe do të përditësojë periodikisht programet monitoruese, me qëllim që:

a) të mbledhë dhe të përditësojë informacionin e nevojshëm për të bërë vlerësimin e sigurisë;

b) të mbledhë informacion për të konfirmuar kushtet e nevojshme për sigurinë e punëtorëve e të publikut dhe mbrojtjen e mjedisit gjatë fazës operative të objektit;

c) të konfirmojë mungesën e çdo elementi që mund të ndikojë në sigurinë pas mbylljes apo nxjerrjes nga përdorimi të depos ose pas mbylljes së depos, sipas rasisë.

2. I licencuari do të krijojë dhe do të zbatojë një program për monitorimin e radioaktivitetit të mjedisit duke filluar nga faza e instalimit deri në fazën e nxjerrjes nga përdorimi ose mbylljen e depos, aty ku është e aplikueshme.

3. I licencuari do të krijojë dhe do të zbatojë gjatë fazës operative dhe mbylljes së objektit programet për monitorimin e shkarkimeve radioaktive në burim.

4. I licencuari do të krijojë dhe do të zbatojë gjatë fazës operative të depos programet për monitorimin e efektivitetit të sistemeve kontrolluese të mbetjeve radioaktive.

5. Në rast të depove afatgjata të mbetjeve radioaktive, i licencuari do të krijojë dhe do të zbatojë, gjatë fazës operative të depos, programet për monitorimin e degradimit lidhur me vjetërsinë e sistemit të kontrollit të mbetjeve radioaktive.

6. Të gjitha programet e monitorimit gjatë procesit të licencimit të depos të menaxhimit të mbetjeve radioaktive miratohen nga KMR-ja.

Neni 52

Rishikimet periodike të sigurisë

1. I licencuari do të bëjë rishikime periodike të sigurisë, të paktën çdo pesë vjet gjatë fazës operative të depos dhe do të zbatojë çdo përditësim të sigurisë që kërkohet nga KMR-ja.

2. I licencuari do t'i paraqesë rezultatet e rishikimit periodik të sigurisë, të dokumentuara në një raport në KMR, së bashku me përditësimet e dokumenteve të përcaktuara, si dokumente mbështetëse për funksionimin e vazhdueshëm.

3. KMR-ja do të ketë të drejtën për të rishikuar afatet dhe kushtet e specifikuar në licencë pas shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës për funksionim të vazhdueshëm.

Neni 53



Funksionimi përtej përshkrimit të jetëgjatësisë së depos

1. Çdo i licencuar, që ka për qëllim të operojë një strukturë të menaxhimit të mbetjeve radioaktive përtej jetëgjatësisë së projektuar të tij, duhet:

a) të rivlerësojë projektimin e depos, funksionimin, mirëmbajtjen, menaxhimin, shkallën e vjetërimit dhe çdo aspekt tjetër që lidhet me sigurinë e depos, sipas rastit;

b) të rinovojë vlerësimet mbështetëse të sigurisë për të përcaktuar propozime për operim të zgjatur të depos, duke marrë parasysh degradimin e objektit lidhur me shkallën e vjetërsisë dhe sistemet e tij, strukturat dhe komponentët e rëndësishëm për sigurinë.

2. I licencuari do t'i dorëzojë KMR-së para përfundimit të jetëgjatësisë së projektuar të depos një kërkesë, e cila duhet të përfshijë sipas rastit:

a) një arsye për zgjatjen e propozuar të jetëgjatësisë së depos, të mbështetur nga rezultatet e demonstrimit të përditësuar të vlerësimit të sigurisë, duke marrë në konsideratë strukturat e vjetruara, sistemet dhe komponentët e rëndësishëm për sigurinë;

b) raportin e fundit të rishikimit periodik të sigurisë;

c) përditësimet e sigurisë të zbatuara gjatë fazës operuese të depos;

d) rezultatet e të gjitha programeve të monitorimit operacional;

e) përditësimet e të gjitha dokumenteve.

3. Përveç kësaj, KMR-ja mund t'i kërkojë të licencuarit:

a) të vlerësojë pacenueshmërinë e sigurisë së pakove të ruajtura të mbetjeve radioaktive, nëpërmjet testimit dhe ekzaminimit;

b) të paraqesë një plan me masat e nevojshme për të zbutur pasojat e ndryshimeve të mundshme në mbetjet radioaktive të depozituara, duke përfshirë:

i) prodhimin e gazeve të rrezikshme;

ii) prodhimin e substancave të djegshme ose gërryese;

iii) gërryerjen e metaleve;

iv) degradimin e sistemit të kontrollit të mbetjeve radioaktive.

4. KMR-ja, pas shqyrtimit të dokumenteve të kërkuara sipas pikave 2 dhe 3, do të marrë një vendim për dhënien e licencës ndaj një depoje për

të operuar përtej jetëgjatësisë së projektuar, për kohëzgjatjen e kërkuar në aplikimin ose siç përcaktohet nga KMR-ja.

5. KMR-ja mund të rishikojë kushtet e specifikuara në licencë, pas shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës për funksionimin përtej jetëgjatësisë së projektuar.

Neni 54

Çmontimi i depos së përkohshme

Çmontimi i depos së përkohshme të mbetjeve radioaktive do të kryhet nga i licencuari duke u bazuar në planin përfundimtar të çmontimit të miratuar nga KMR-ja dhe në përputhje me afatet, e kushtet e vendosura nga KMR-ja, sipas licencës për çmontim. I licencuari kryen matjet e nevojshme duke siguruar që asnjë rrezik nuk mbetet pas mbylljes së depos.

PJESA IV

TË DHËNAT DHE RAPORTIMI

Neni 55

Të dhënat e mbetjeve radioaktive

1. Mbajtësit e licencës, që ruajnë përkohësisht ose në afat të gjatë, kanë gjendje apo depozitojnë mbetje radioaktive ose që shkarkojnë mbetje radioaktive, do të mbajnë të dhënat e mbetjeve radioaktive, duke përfshirë informacion në lidhje me aspektet e mëposhtme, sipas rastit:

a) kohëzgjatjen;

b) procesin e kondicionimit;

c) ruajtjen e tij;

d) depozitim;

e) shkarkimin;

dh) pastrimin;

e) transferimin.

2. Për çdo pako ose objekt në depo ose nën kondicionim, mbajtësi i licencës duhet të përmbajë të dhënat e specifikuara në pikën 1 dhe do të përfshijë informacion mbi historinë e menaxhimit, informacionin përkatës për pranimin në depo apo për hapat e mëtejshëm të menaxhimit, sipas rastit, në përputhje me aneksin III, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje.

3. Për çdo shkarkim radioaktiv, të dhënat e përshkruara specifikisht në pikën 1 do të sigurojnë si minimum informacion mbi rrugët e shkarkimit.



sasinë e mbetjeve radioaktive të shkarkuara dhe informacionin që tregon përputhje me limitet e autorizuar të shkarkimit, siç është specifikuar në shtojcën IV, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje.

4. Për çdo pako ose send të pastruar apo transferuar nga depoja e menaxhimit të mbetjeve radioaktive jashtë saj ose te një person tjetër i licencuar për riciklim ose ripërdorim ose kthim te furnizuesi, sipas rastit, të dhënat e specifikuara në pikën 1 do të përfshijnë, përveç informacionit të specifikuar në pikën 2, datën dhe vendndodhjen e transferimit, në përputhje me shtojcën V.

5. Mbajtësi i licencës duhet të mbajë shënimet për mbetjet radioaktive gjatë fazës operuese dhe çmontuese të depos.

6. Në rast të mbylljes apo asgjësimit, mbajtësi i licencës do të transferojë shënimet për mbetjet radioaktive të marrësi ose asgjësuesi dhe të njoftojë në përputhje me rrethanat KMR-në.

7. Të licencuarit që operojnë depo të mbetjeve radioaktive do të marrin të dhëna mbi mbetjet radioaktive të hedhura gjatë gjithë periudhës së mbikëqyrjes afatgjatë të depos.

Neni 56

Regjistri Kombëtar i Mbetjeve Radioaktive

1. Regjistri Kombëtar i Mbetjeve Radioaktive do të mbahet dhe nga ZMR-ja.

2. Regjistri kombëtar do të mbajë informacion mbi mbetjet radioaktive, si më poshtë vijon:

a) një regjistër të të gjithë atyre që i posedojnë ato;

b) të atyre të shkarkuara në mjedis;

c) të çliruara nga kontrolli rregullator;

ç) të transferuara;

d) të kthyer te furnizuesi;

e) të dërguara jashtë vendit për trajtim ose të eksportuara.

3. Regjistri kombëtar gjithashtu do të përmbajë informacion mbi parashikimet vjetore për prodhimin e mbetjeve radioaktive që priten gjatë fazës operationale dhe demonstruese të të gjitha instalimeve që prodhojnë mbetje radioaktive.

4. Regjistri kombëtar do të përditësohet çdo vit, në bazë të informacionit të dërguar nga ana e mbajtësve të autorizimit.

Neni 57

Raportimi i informacionit mbi mbetjet radioaktive

Mbajtësit e licencës duhet të paraqesin në KMR brenda datës 1 mars të vitit të ardhshëm format e dhëna në shtojcat III, IV dhe V, sipas rastit, të plotësuar me të dhëna deri në 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 58

Njoftimi dhe raportimi i shkarkimeve të palicencuara

1. Në rast të shkarkimeve të palicencuara ose shkarkimeve që tejkalojnë nivelet e autorizuar, mbajtësi i autorizimit duhet të marrë masat e mëposhtme:

a) të njoftojë KMR-në jo më vonë se njëzet e katër orë nga ngjarja;

b) të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ndaluar shkarkimin e mëtejshëm dhe shpërndarjen, nëse është e mundur;

c) të paraqesë një raport të plotë për KMR-në brenda tridhjetë ditësh pas njoftimit.

2. Raporti i specifikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, do të përfshijë informacionin e mëposhtëm për përshkrimin e incidentit;

a) një karakterizim të shkarkimit, përfshirë rrugën e shkarkimit, pikën e shkarkimit, aktivitetin e përgjithshëm, përmbajtjen e radionuklideve, sasinë dhe vëllimin e shkarkuar, formën kimike dhe atë fizike;

b) ekspozimin e mundshëm të individëve ndaj rrezatimit, rrethanat në të cilat ekspozimi mund të ndodhë dhe shkallën e rrezikut të mundshëm për publikun;

c) veprimet që janë ndërmarrë për të ndaluar shkarkimin;

ç) masat të cilat janë marrë ose do të merren për të parandaluar një përsëritje të ngjarjeve të ngjashme;

d) çdo informacion tjetër, siç kërkohet nga zotëruesi i licencës ose nga KMR-ja.

Neni 59

Njoftimi dhe raportimi i humbjes, vjedhjes ose sabotimit

1. Mbajtësi i licencës, në rast se zbulon ndonjë vjedhje, humbje apo sabotim të mbetjeve radioaktive në posedimin/kontrollin e tyre të marrë masat e mëposhtme:

a) të njoftojë KMR-në sa më shpejt të jetë e



mundur, por jo më vonë se njëzet e katër orë pas zbulimit të vjedhjes, humbjes apo sabotimit;

b) të ndërmarrë veprime për të rimarrë mbetjet radioaktive dhe për të siguruar objektin, nëse është e nevojshme;

c) të paraqesë një raport të plotë për KMR-në brenda tridhjetë ditësh pas njoftimit.

ç) të njoftojë menjëherë organet e Policisë së Shtetit për zbulimin ose jo të vjedhjes, humbjes apo sabotimit, si dhe autoritet përgjegjëse në bashki e prefekturë.

2. Raporti i specifikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) një përshkrim të mbetjeve radioaktive, përfshirë klasën, sasinë, formën kimike dhe atë fizike;

b) një përshkrim të rrethanave në të cilat ka ndodhur vjedhja, humbja apo sabotimi;

c) një deklaratë të vendndodhjes apo vendndodhjen e mundshme të mbetjeve radioaktive;

ç) ekspozimin e mundshëm të individëve ndaj rrezatimit, rrethanat në të cilat ekspozimi mund të ndodhë dhe shkallën e rrezikut të mundshëm për publikun;

d) veprimet që janë ndërmarrë ose do të merren për të rimarrë mbetjet radioaktive;

dh) procedurat ose masat të cilat janë ose do të miratohen për të parandaluar një përsëritje të ngjarjeve të ngjashme;

e) çdo informacion tjetër, siç kërkohet nga zotëruesi i autorizimit ose nga KMR-ja.

3. Çdo person, i cili zbulon mbetjet radioaktive jashtë kontrollit, njofton menjëherë KMR-në, e cila merr të gjitha masat e nevojshme për të kufizuar aksesin e publikut në këtë zonë.

PJESA IV DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 60

Dispozitat kalimtare

1. Mbajtësit e licencave për aktivitete që prodhojnë mbetje radioaktive, të vlefshme në momentin e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave të ndryshuara, do të jenë në përputhje me kërkesat e reja brenda dy vjetëve, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij dokumenti.

2. Të licencuarit që operojnë në objektet e

menaxhimit të mbetjeve radioaktive në momentin e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave të ndryshuara do të rishikojnë sigurinë e objektit për të verifikuar përputhshmërinë me kërkesat e reja, brenda katër viteve, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij dokumenti.

3. Përditësimet e sigurisë do të bëhen nga mbajtësi i licencës së depos të menaxhimit të mbetjeve radioaktive, pas shqyrtimit të sigurisë të specifikuar në pikën 2.

ANEKSI I KRITERET E ÇLIRIMIT

Rreziqet e rrezatimit që vinë nga materiali i shkarkuar të jenë mjaftueshëm të ulëta, në mënyrë që të mos kërkojnë kontroll rregullator.

Materialet për çlirim mund të pranohen pa shqyrtim të mëtejshëm, me kusht që në të gjitha situatat e parashikueshme doza efektive që pritet të merret nga çdo anëtar i publikut të jetë 10 μSv , ose më pak në një vit.

Materialet radioaktive në një praktikë të licencuar mund të çlirohen pa shqyrtim të mëtejshëm, në kushtet e mëposhtme:

a) përqendrimi i aktivitetit të radionuklideve individuale me origjinë artificiale në formë të ngurtë nuk e tejkalon nivelin e dhënë në tabelën I; ose

b) përqendrimet e aktiviteteve të radionuklideve natyrale nuk e tejkalon nivelin e dhënë në tabelën II; ose

c) për radionuklidet natyrale në mbetjet që mund të riciklohen në materiale ndërtimi ose largimi i të cilave mund të shkaktojë kontaminimin e ujit të pijshëm, përqendrimi i aktivitetit në mbetje nuk kalon vlerat specifike që rrjedhin aq sa për të përmbushur një kriter dozë prej 10 μSv në një vit.

1. Çlirimi mund të lejohet nga KMR-ja për situata të veçanta, duke marrë në konsideratë dhe formën fizike ose kimike të materialit radioaktiv dhe përdorimin e tij.

2. Për çlirimin e materialit radioaktiv që përmban më shumë se një radionuklid artificial, në bazë të niveleve të dhëna në tabelën I, kusht për pranimin është që shuma e përqendrimeve individuale të aktiviteteve të radionuklideve të jetë më pak se niveli për pranimin e përzierjeve (X_m), i cili përcaktohet si vijon:



$$X_m = \frac{1}{\sum_{i=1}^n \frac{f(i)}{X(i)}}$$

ku:

- f (i) është fraksioni i përqendrimit të aktivitetit të radionuklideve (i) në përzierje;

- X (i) është niveli i aplikueshëm për radionuklidin (i) të dhënë në tabelën I; dhe
- n është numri i radionuklideve të pranishëm.

Tabela I

NIVELET PËR ÇLIRIMIN E MATERIALEVE RADIOAKTIVE PA SHQYRTIM TË MËTEJSHËM
- PËRQENDRIMET E AKTIVITETEVE TË RADIONUKLIDEVE ARTIFICIALE

Radionuklidet	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/g)	Radionuklidet	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/g)	Radionuklidet	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/g)
H-3	100	Fe-59	1	Sr-89	1000
Be-7	10	Co-55	10	Sr-90 ^a	1
C-14	1	Co-56	0.1	Sr-91 ^a	10
F-18	10	Co-57	1	Sr-92	10
Na-22	0.1	Co-58	1	Y-90	1000
Na-24	1	Co-58m	10 000	Y-91	100
Si-31	1000	Co-60	0.1	Y-91m	100
P-32	1000	Co-60m	1000	Y-92	100
P-33	1000	Co-61	100	Y-93	100
S-35	100	Co-62m	10	Zr-93	10
Cl-36	1	Ni-59	100	Zr-95 ^a	1
Cl-38	10	Ni-63	100	Zr-97 ^a	10
K-42	100	Ni-65	10	Nb-93m	10
K-43	10	Cu-64	100	Nb-94	0.1
Ca-45	100	Zn-65	0.1	Nb-95	1
Ca-47	10	Zn-69	1000	Nb-97 ^a	10
Sc-46	0.1	Zn-69m ^a	10	Nb-98	10
Sc-47	100	Ga-72	10	Mo-90	10
Sc-48	1	Ge-71	10 000	Mo-93	10
V-48	1	As-73	1000	Mo-99 ^a	10
Cr-51	100	As-74	10	Mo-101 ^a	10
Mn-51	10	As-76	10	Tc-96	1
Mn-52	1	As-77	1000	Tc-96m	1000
Mn-52m	10	Se-75	1	Tc-97	10
Mn-53	100	Br-82	1	Tc-97m	100
Mn-54	0.1	Rb-86	100	Tc-99	1
Mn-56	10	Sr-85	1	Tc-99m	100
Fe-52 ^a	10	Sr-85m	100	Ru-97	10
Fe-55	1000	Sr-87m	100	Ru-103 ^a	1
Ru-105 ^a	10	Cs-135	100	Ir-194	100
Ru-106 ^a	0.1	Cs-136	1	Pt-191	100
Rh-103m	10 000	Cs-137 ^a	0.1	Pt-193m	1000
Rh-105	100	Cs-138	10	Pt-197	1000
Pd-103 ^a	1000	Ba-131	10	Pt-197m	100
Pd-109 ^a	100	Ba-140	1	Au-198	10
Ag-105	1	La-140	1	Au-199	100
Ag-110m ^a	0.1	Ce-139	1	Hg-197	100
Ag-111	100	Ce-141	100	Hg-197m	100
Cd-109 ^a	1	Ce-143	10	Hg-203	10
Cd-115 ^a	10	Ce-144	10	Tl-200	10



Radionuklidet	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/g)	Radionuklidet	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/g)	Radionuklidet	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/g)
Cd-115m ^a	100	Pr-142	100	Tl-201	100
In-111	10	Pr-143	1000	Tl-202	10
In-113m	100	Nd-147	100	Tl-204	1
In-114m ^a	10	Nd-149	100	Pb-203	10
In-115m	100	Pm-147	1000	Bi-206	1
Sn-113 ^a	1	Pm-149	1000	Bi-207	0.1
Sn-125	10	Sm-151	1000	Po-203	10
Sb-122	10	Sm-153	100	Po-205	10
Sb-124	1	Eu-152	0.1	Po-207	10
Sb-125 ^a	0.1	Eu-152m	100	At-211	1000
Te-123m	1	Eu-154	0.1	Ra-225	10
Te-125m	1000	Eu-155	1	Ra-227	100
Te-127	1000	Gd-153	10	Th-226	1000
Te-127m ^a	10	Gd-159	100	Th-229	0.1
Te-129	100	Tb-160	1	Pa-230	10
Te-129m ^a	10	Dy-165	1000	Pa-233	10
Te-131	100	Dy-166	100	U-230	10
Te-131m ^a	10	Ho-166	100	U-231 ^a	100
Te-132 ^a	1	Er-169	1000	U-232 ^a	0.1
Te-133	10	Er-171	100	U-233	1
Te-133m	10	Tm-170	100	U-236	10
Te-134	10	Tm-171	1000	U-237	100
I-123	100	Yb-175	100	U-239	100
I-125	100	Lu-177	100	U-240 ^a	100
I-126	10	Hf-181	1	Np-237 ^a	1
I-129	0.01	Ta-182	0.1	Np-239	100
I-130	10	Ē-181	10	Np-240	10
I-131	10	Ē-185	1000	Pu-234	100
I-132	10	Ē-187	10	Pu-235	100
I-133	10	Re-186	1000	Pu-236	1
I-134	10	Re-188	100	Pu-237	100
I-135	10	Os-185	1	Pu-238	0.1
Cs-129	10	Os-191	100	Pu-239	0.1
Cs-131	1000	Os-191m	1000	Pu-240	0.1
Cs-132	10	Os-193	100	Pu-241	10
Cs-134	0.1	Ir-190	1	Pu-242	0.1
Cs-134m	1000	Ir-192	1	Pu-243	1000
Pu-244 ^a	0.1	Cm-246	0.1	Cf-252	1
Am-241	0.1	Cm-247 ^a	0.1	Cf-253	100
Am-242	1000	Cm-248	0.1	Cf-254	1
Am-242m ^a	0.1	Bk-249	100	Es-253	100
Am-243 ^a	0.1	Cf-246	1000	Es-254 ^a	0.1
Cm-242	10	Cf-248	1	Es-254m ^a	10
Cm-243	1	Cf-249	0.1	Fm-254	10 000
Cm-244	1	Cf-250	1	Fm-255	100
Cm-245	0.1	Cf-251	0.1		

^a radionuklidet mëmë dhe bijat e tyre, dozat e të cilave janë marrë në konsideratë në llogaritjen e dozës përfundimtare (kjo kërkon të merret parasysh vetëm niveli i çlirimit të radionuklideve mëmë), janë si më poshtë:



Fe-52 Mn-52m
 Zn-69m Zn-69
 Sr-90 Y-90
 Sr-91 Y-91m
 Zr-95 Nb-95
 Zr-97 Nb-97 m, Nb-97
 Nb-87 Nb-97 m
 Mo-99 Tc-99 m
 Mo-101 Tc-101
 Ru-103 Rh-103m
 Ru-105 Rh-105m
 Ru-106 Rh-106
 Pd-103 Rh-103m
 Pd-109 Ag-109m
 Ag-110m Ag-110
 Cd-109 Ag-109m
 Cd-115 In-115
 Cd-115 m In-115
 In-114 m In-114
 Sn-113 In-113
 Sb-125 Te-125 m
 Te-127 Te-127
 Te-129 m Te-129
 Te-131 m Te-131
 Te-132 I-132
 Cs-137 Ba-137 m
 Ce-144 Pr-144, Pr-144 m
 U-232sec Th-228, Ra-224, RN-220, Po-216, Pb-212, Bi-212, TL-208
 U-240 Np-240, Np-240
 Am-242m Np-238, Am-243, Np-239
 Cm-247 Pu-243
 Es-254 Bk-250
 Es-254m Fm-254

Tabela II

NIVELET PËR ÇLIRIMIN E MATERIALEVE TË NGURTA PA SHQYRTIM TË MËTEJSHËM
- PËRQENDRIMET E AKTIVITETEVE TË RADIONUKLIDEVE ME ORIGINË NATYRALE

Radionuklidet	Përqendrimi i aktivitetit(Bq / g)
K-40	10
Çdo radionuklid i zbërthyer nga zinxhiri i uranimit dhe toriumit	1

ANEKSI II

KLASIFIKIMI I MBETJEVE RADIOAKTIVE

Klasa	Përshkrimi
Mbetje të pastra për çlirim	Mbetjet radioaktive që plotësojnë nivele të çlirimit në shtojcën 1.
Mbetje me jetë shumë të shkurtër	Mbetjet radioaktive që përmbajnë vetëm radionuklide me periudhë përgjysmimi shumë të shkurtër (zakonisht më pak se 100 ditë), me përqendrimet të aktivitetit mbi nivelet e çlirimit, por që mund të ruhen për zbërthim për një periudhë të caktuar (deri në disa vite), për çlirim të mëvonshëm. Shembull: mbetjet radioaktive që prodhohen nga kërkimet mjekësore dhe industriale me radionuklid me jetë të shkurtër.
Mbetje të nivelit shumë të ulët	Mbetjet radioaktive që përmbajnë nivele të ulëta të përqendrimeve të aktivitetit (lehtësisht mbi nivelet e çlirimit) dhe përqendrimet shumë të limituara të radionuklideve me jetë shumë të gjatë, për të cilat nuk duhen nivele të larta të mbajtjes nën kontroll dhe izolimit (të jenë të përshtatshme për t'u vendosur në gropa afër sipërfaqes së tokës me kontrole të kufizuara rregullatore. Shembull: tokë dhe dhera që vijnë nga veprime dhe çmontime e një aktiviteti bërthamor, mbetjet që përmbajnë radionuklide që vijnë nga përmiximi i mineraleve ose veprimet.



Mbetje të nivelit të ulët	Mbetjet radioaktive që përmbajnë një sasi materiali radioaktiv, i cili kërkon mbajtje nën kontroll dhe izolim në nivele të larta për një periudhë kohore të caktuar (deri në disa qindra vite); një mbetje e tillë është e përshtatshme për t'u depozituar afër sipërfaqes (deri në 30m nga sipërfaqja). Këto mbetje përmbajnë mesatarisht nga 400 Bq/g për radionuklidin me jetë të gjatë alfa (gjysmëjeta më e madhe se 30 vite) deri 4000 Bq/g për paketime individuale.
Mbetje të nivelit mesatar	Mbetjet radioaktive që përmbajnë radionuklide me jetë të gjatë dhe që depozitohen në thellësi mesatare (nga 10 deri në disa qindra metra), pa ose vetëm me kushte të limituar për çlirim nxehtësie.
Mbetje të nivelit të lartë	Mbetjet radioaktive me përqendrim shumë të larta të aktivitetit që prodhojnë nxehtësi, zbërthime të dukshme ose me sasi të madhe të radionuklideve me jetë të gjatë, të cilat kërkojnë depozitim në thellësi, formacione gjeologjike të qëndrueshme (shumë, qindra metra nën sipërfaqen e tokës).

ANEKSI III FORMA E INVENTARIT TË MBETJEVE RADIOAKTIVE

#	Të dhëna	Lloji
1	I licencuari	Emri dhe adresa e mbajtësit të autorizimit
2	Objekti	Emri dhe adresa e objektit ku mbetjet radioaktive janë vendosur
3	Licenca	Numri dhe lloji i autorizimit të bartësit
4	ID e pakos/ artikullit	Numri unik i identifikimit të pakos së mbetjeve radioaktive ose artikulli (në rast të mbetjeve radioaktive të papaketuara)
5	Vendndodhja	Vendndodhja e saktë (ndërtesa, dhoma, zona) e pakos apo artikullit brenda objektit
6	Kategoria	Kategoria e mbetjeve radioaktive, sipas klasifikimit operacional
7	Lloji	Përshkrim i shkurtër i vetive përkatëse të mbetjeve radioaktive
8	Prodhuar	Data e prodhimit të mbetjeve radioaktive
9	Prodhuesi	Emri dhe adresa e prodhuesit të mbetjeve radioaktive, nëse është i ndryshëm nga zotërimi i autorizimit të raportuar
10	Paketimi	Lloji i miratuar i paketimit ose përshkrimi i sendit (në rast të mbetjeve radioaktive të papaketuar)
11	Masa	Masa e pakos ose artikullit (kg)
12	Vëllimi	Vëllimi i pakos ose artikullit (m ³)
13	Kondicionimi	Procesi i kondicionimit të kryhet ose i nevojshme të kryhet
14	Ndodja radioaktive	Vlera e matur e ndotjes sipërfaqësore të pakos (Bq / cm ²)
15	Doza e ambientit	Vlera maksimale e dozës të matur në kontakt me pakon apo sendin dhe në 1m distancë nga pako apo sendi (Sv / h)
16	Aktiviteti i përgjithshëm	Aktiviteti i mbetjeve radioaktive (Bq)
17	Inventari i radionuklideve	Një listë e radionuklideve dhe përqendrimit e aktivitetit të tyre (Bq/masë për njësi), të identifikuar nga matja në datën

ANEKSI IV FORMA E SHKARKIMIT TË MBETJEVE RADIOAKTIVE

#	Të dhëna	Lloji			
1	I licencuari	Emrin dhe adresën e mbajtës të licencës			
2	Objekti	Emri dhe adresa e objektit ku mbetjet radioaktive janë vendosur			
3	Licenca	Numri dhe lloji i licencës			
4	Lloji i shkarkimit (plotëso kutinë e dubur)	I lëngshëm		Pluhur	
5	Rruga e shkarkimit (plotëso kutinë e dubur)	Atmosferë		Sistem kanalizimi	
6	Pika e shkarkimit (plotëso kutinë e dubur)	Tub ventilimi		tjetër	
		Kanal shkarkimi		(ju lutemi shënoni)	
7	Kohëzgjatje	Fillimi i shkarkimit - fundi i shkarkimit			
8	Sasia	Volumi i shkarkuar (m³)			
9	Aktiviteti i përgjithshëm	Aktiviteti i përgjithshëm i shkarkuar në (Bq)			
10	Inventari i radionuklideve	Një listë e radionuklideve dhe përqendrimit e aktivitetit të tyre (Bq/njësi masive), pesha në aktivitetin total (%) dhe koeficientin e tyre (të aktivitetit të shkarkimit/ kushtit të autorizuar)			



SHTOJCA V FORMA E TRANSFERIMIT TË MBETJEVE RADIOAKTIVE

#	Të dhëna	Lloji																		
1	I licencuari	Emrin dhe adresën e mbajtësit të autorizimit																		
2	Objekti	Emri dhe adresa e objektit ku mbetjet radioaktive janë vendosur																		
3	Licenca	Numri dhe lloji i autorizimit të bartësit																		
4	ID e pakos/artikullit	Numri unik i identifikimit të pakos së mbetjeve radioaktive ose artikulli (në rast të mbetjeve radioaktive të papaketuara)																		
5	Kategoria	Kategoria e mbetjeve radioaktive, sipas klasifikimit operacional																		
6	Lloji	Përshkrim i shkurtër i vetive përkatëse të mbetjeve radioaktive																		
7	paketim	Lloji i miratuar i paketimit ose përshkrimi i sendit (në rast të mbetjeve radioaktive të papaketuar)																		
8	Masa	Masa e pakos ose artikullit (kg)																		
9	Vëllimi	Vëllimi i pakos ose artikullit (m ³)																		
10	Kondicionimi	Procesi i kondicionimit të kryhet (nëse është i nevojshëm)																		
11	Ndodja radioaktive	Vlera e matur e ndodjes sipërfaqësore të sendit ose pakos (Bq / cm ²)																		
12	Doza e ambientit	Vlera maksimale e dozës të matur në kontakt me pakon apo sendin dhe në 1m distancë nga pako apo sendi (Sv / h)																		
13	Aktiviteti i përgjithshëm	Aktiviteti i mbetjeve radioaktive (Bq)																		
14	Inventari i radionukleide	Një listë e radionuklideve dhe përqendrimit e aktivitetit të tyre (Bq/g), të identifikuar nga matja në datën																		
15	Data e transferimit	Data kur pako ose artikulli/ sendi i mbetjeve radioaktive është larguar nga objekti																		
16	Lloji i transferimit (plotëso kutinë e duhur)	<table><tr><td>çlirim</td><td></td><td>trajtim</td><td></td><td>kthimi</td><td></td></tr><tr><td>ripërdorim</td><td></td><td>ruajtje</td><td></td><td>tjetër</td><td></td></tr><tr><td>riciklim</td><td></td><td>depozitim</td><td></td><td>(ju lutem përshkruani)</td><td></td></tr></table>	çlirim		trajtim		kthimi		ripërdorim		ruajtje		tjetër		riciklim		depozitim		(ju lutem përshkruani)	
çlirim		trajtim		kthimi																
ripërdorim		ruajtje		tjetër																
riciklim		depozitim		(ju lutem përshkruani)																
17	Destinacioni i transferimit	Emri dhe adresa e pranuesit/ priftësit të pakos apo artikullit/ sendit të mbetjeve radioaktive																		
18	Miratimi	Numrin dhe datën e miratimit për çlirim ose transferim, të lëshuar nga KMR-ja																		

SHTOJCA VI SISTEMI I KLASIFIKIMIT TË BURIMEVE TË KONSUMUARA

Periudha e përgjysmimit	Aktiviteti në Bq	Opsioni i preferuar		Opsioni alternativ	
		Përpunimi	Hapi final	Përpunimi	Hapi final
<100 ditë	(All)	Zbërthimi	Çlirimi nga kontrolli rregullator	Kondicionim i mbetjeve në një paketim standard	Vendosja në depon përfundimtare në sipërfaqe
>100 ditë <30 vjet	<106	Kondicionim i mbetjeve në një paketim standard	Vendosja në depon përfundimtare në sipërfaqe	Paketimi për transport	Kthimi te furnizuesi
>100 ditë <30 vjet	>106	Paketimi për transport	Kthimi te furnizuesi	Kondicionim i mbetjeve në një paketim special	Vendosja në depon përfundimtare në thellësi të tokës
>30 vjet	<103	Kondicionim i mbetjeve në një paketim standard	Vendosja në depon përfundimtare në sipërfaqe	Paketimi për transport	Kthimi te furnizuesi
>30 vjet	>103	Paketimi për transport	Kthimi te furnizuesi	Kondicionim i mbetjeve në një paketim special	Vendosja në depon përfundimtare në thellësi të tokës

VENDIM

Nr. 640, datë 7.9.2016

PËR KALIMIN E SPORTELEVE TË SHËRBIMIT TË FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 50, të ligjit nr. 13/2016,

“Për mënyrën e ofrimit në sportel të shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e sporteleve të shërbimit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) në administrim të Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), në bashkitë Kavajë e Fier.